




ROMA
INTEGRATION
2020

INTEGRIMI I ROMËVE



Projekti bashkë-financohet nga:



Regional Cooperation Council

INTEGRIMI I ROMËVE 2020

Ekipi aksionar për integrimin e Romëve 2020 në kuadër të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim punon në

forcimin e përgjegjësive institucionale të qeverive për të instaluar dhe plotësuar qëllime konkrete që kanë të bëjnë me integrimin e Romëve në kuadër të politikave të përgjithshme dhe buxhetit të shtetit, me çka do të reduktohet hendeku socio-ekonomik ndërmjet Romëve dhe popullatës jo-Rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

KU DËSHIROJMË TË JEMI?

Qëllimet tona janë:

- Implementim i përshpejtuar, koordinim më i mirë ndër-sektorial dhe zhvillim të kapaciteteve institucionale për integrimin e Romëve
- Çështjet Rome të përfshihen në politikat e përgjithshme në kuadër të bashkëpunimit rajonal duke i integruar politikat në kontekst dhe standarde rajonale.
- Vendosje të sistemit të përshtatshëm për përcjellje të integrimin të Romëve.
- Reflektim të praktikave të BE-së për integrimin e Romëve në rajon



Ç'KEMI BËRI DERI TANI RRUGËS DREJT KËTIJ QËLLIMI?

- **Kemi filluar me projektin Integrimi i Romëve 2020** duke e formuar Ekipin aksionar dhe kemi përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë, nga rajoni, për të forcuar përkushtimin e tyre për integrimin e Romëve dhe për projektin
- **Kemi organizuar platforma për debate** publike për integrimin e Romëve në të gjitha vendet pjesëmarrëse
- **Kemi krijuar Trup punues** që do të përbëhet prej Pikave kombëtare të kontaktit për Romët dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga rajoni, që do të takohet një herë në vit dhe do të vendosë standarde rajonale për politikën për integrimin e Romëve
- **Kemi propozuar standarde për përcjellje dhe raportim** për integrimin e Romëve që në mbledhjen e parë u miratuan nga Trupi punues i projektit Integrimi i Romëve 2020
- **Kemi trajnuar zyrtarë publikë përkatës**, të ngarkuar me integrimin e Romëve në fushën e arsimit, punësimit, banimit, shëndetësisë, evidencës civile, financave dhe statistikës për përcjellje dhe raportim për integrimin e Romëve
- **Kemi siguruar asistencë teknike dhe ekspertizë** për qeveritë e rajonit për të hartuar planet vjetore dhe buxhet përkatës për implementim të politikave të tyre për integrimin e Romëve.




KU GJENDET RAJONI AKTUALISHT?

Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia:

- Kanë miratuar politika për integrimin e Romëve në formë të strategjive dhe/ose planeve aksionare
- Kanë emëruar Persona për pika kombëtare për Romët (PPKR) të cilët marrin pjesë në projektin për Integrimin e Romëve 2020, duke i drejtuar politikat për integrimin e Romëve
- Kanë miratuar standarde rajonale për përcjellje dhe raportim për politikat për integrimin e Romëve
- Kanë realizuar një sërë masash të ndryshme premtuese për integrimin e Romëve me perspektivë që në të ardhmen të institucionalizohen
- E kanë pranuar nevojën për përmirësim të planifikimit buxhetor, distribuimin dhe shpenzimin e mjeteve për politikat e tyre për integrimin e Romëve
- E kanë vërtetuar nevojën për përfshirjen e çështjeve të Romëve në politikat e përgjithshme socio-ekonomike, posaçërisht politikat për arsim, punësim, banim, shëndetësi dhe për evidencën civile
- E kanë pranuar se mungon sistem i avancuar për përcjellje të integritetit të Romëve
- E kanë vënë në dukje nevojën për veprim më të vendosur në trajtimin e diskriminimit kundër Romëve si shkak themelor për varfërinë, marginalizimin dhe përjashtimin e tyre.



ÇKA MENDOJNË NJERËZIT KOMPANITË?



**VETËM
7%**

e kompanive nga Evropa Juglindore thonë se punësojnë Romë, përqindja më e lartë në



**SHQIPËRI
18%**

**NDËRSA MË E ULËTA
NË MAL TË ZI**

**VETËM
3%**



Sipas gjetjeve të **Barometrit Ballkanik 2016** të KRB-së popullata Rome ka mundësi dukshëm më të madhe për të gjetur punë në kompani të orientuara në eksport, kompani të orientuara në import, firma të mëdha dhe kompani të faturuara dhe raportohet se

20% TO KOMPANIVE TË TILLA KANË PUNËTORË NGA POPULLATA ROME.

70%

të njerëzve në EJJ pajtohen se qeveritë duhet të sigurojnë masa afirmative dhe të promovojnë mundësi për Romët gjatë aplikimit për punë në sektorin publik.

76%

e qytetarëve në EJJ mendojnë se qeveritë duhet të instalojnë masa afirmative për popullatën Rome gjatë regjistrimit në shkollë të mesme ose fakultet.

69%

e qytetarëve në EJJ mendojnë se qeveritë e tyre duhet të ndërmarrin më tepër masa për të siguruar kushte më të mira banimi për Romët.

ÇKA DO TË BËJMË PËR TË NDRYSHUAR GJENDJEN DHE SI?

Mbështetja institucionale për:

- **Strukturim institucional:** PPKR dhe trupa ndër-disiplinare;
- **Forcim të kapacitetit:** takime konsultative dhe trajnime;
- **Rekomandim të politikave:** përmbledhje, propozime dhe këshilla;
- **Platforma kombëtare** (forume për dialog publik);
- **Punëtori rajonale** për zhvillim të kapaciteteve dhe shkëmbim të përvojave.

Bashkëpunim rajonal

- **Takime të nivelit të lartë** për të përcaktuar politika të përbashkëta;
- Takime të **Trupit punues** për menaxhim të projektit;
- **Ndërlidhje** të integrimit të Romëve me punën e KBR-në;
- **Dukshmëri:** buletin, ueb-sajt, monografi.

ABshkëpunim me BE EY & bashkëpunim
ndërkombëtar

- **Raportim:** raporte vjetor për implementim dhe ndikimi;
- Pjesëmarrje dhe shkëmbim në nivel të **BE-së dhe nivel** ndërkombëtar;
- Reflektim të **kornizës** së BE-së dhe kontribut në procesin e anëtarësimit në BE.



EKIPIN AKSIONAR PËR INTEGRIMIN E ROMËVE 2020 E PËRBËJNË



ALEKSANDRA BOJADJEVA
EKSPERTE PËR POLITIKA
aleksandra.bojadjeva@rcc.int



RADA KRSTANOVIĆ
ASISTENTE ADMINISTRATIVE
rada.krstanovic@rcc.int



ORHAN USEIN
LIDER I EKIPIT
orhan.usein@rcc.int



ALENKA VERBOLE
EKSPERTE PËR POLITIKA
alenka.verbole@rcc.int

Ekipi aksionar për integrimin e Romëve 2020 punon në reduktimin e hendekut socio-ekonomik ndërmjet Romëve dhe popullatës jo Rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi nëpërmjet implementimit të masave kombëtare të cilat përfshijnë distribuim të mjeteve adekuate dhe përfshirje të hapave konkretë në politikat për arsim, punësim, shëndetësi, banim dhe evidencë civile.

INTEGRIMI I ROMËVE 2020

ARSIM
PUNËSIM
BANIM
SHËNDETËSI

EVIDENCË CIVILE
MOS DISKRIMINIM
REDUKTİM TË VARFËRISË
BARAZI GJINORE

Këshilli për bashkëpunim rajonal punon në bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian e euroatlantik të Evropës Juglindore që të përshpejtohet zhvillimi i rajonit për të mirën e të gjithë njerëzve që jetojnë në të.

Mirë. Më mirë. Në nivel rajonal.



Zyra e Ekipit aksionar:

Ruzveltova 61, Beograd, Srbija
T +381 (11) 4046 891 F +381 (11) 4046 894



rcc.int/romaintegration2020



[RomaIntegration2020](https://www.facebook.com/RomaIntegration2020)



[recint](https://twitter.com/recint)



RegionalCooperationCouncil

Regional Cooperation Council Secretariat

Trg Bosne i Hercegovine 1/V
71000 Sarajevo, Bosna i Hercegovina
T +387 33 561 700 F +387 33 561 701 E rcc@rcc.int



rcc.int



[RegionalCooperationCouncil](https://www.facebook.com/RegionalCooperationCouncil)



[recint](https://twitter.com/recint)



[RCCSec](https://www.youtube.com/RCCSec)



[RegionalCooperationCouncil](https://www.linkedin.com/company/RegionalCooperationCouncil)